



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

Nr. 3533 Prot

Maliq, më 14.08.2017

KONTRATË

E lidhur sot në datën 01.08.2017 midis Bashkisë Maliq e përfaqësuar nga Titullari Z.Gëzim Topçiu dhe shoqërsë "EDIFAT", me Nipt K53821602S, me Liçensë MK.0436/3 "Për mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit", e përfaqësuar nga Administratori Z. Edmond Mecaj i pajisur me Karte Identiteti Nr. F710100720 i quajtur më poshtë KONTRAKTUESI,

BAZA LIGJORE

Ligji Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar neni 29, pika 5, V.K.M. Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kodi Civil Ligji Nr.7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar, Ligji Nr.8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" Kreu III "Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit" Neni 7, i ndryshuar, V.K.M. Nr.68, datë 15.02.2001, pika 2 "Për miratimin e kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit", Udhëzimi i K.M. Nr.1 datë 22.02.2005 "Për disa shtesa të Udhëzimit Nr.3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"".

KUSHTET E KONTRATËS

Neni 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Mbikëqyrja e punimeve në objektin: "Rehabilitim i shkollës 9 -vjeçare Podgorie dhe rrijetëzimiti terreneve sportive të shkollës, N.J.A., Vreshtas".

Neni 2

KOHEZGJATJA E KONTRATËS

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës është 3 (tre) muaj nga data e nisjes së punimeve në objekt.


Neni 3

VLERA E KONTRATËS

Vlera e kontratës sipas Ofertës të paraqitur në tender është :

40.000 (dyzetmijë) lekë pa Tvsh

48.000 (dyzetetëtmijë) lekë me Tvsh



**Neni 4**  
**AFATET E PAGESES**



Pagesa do të kryhet nga Autoriteti Kontraktor pas përfundimit të punimeve.  
Pagesa do të kryhet në lekë Shqiptare në Bankën Kombëtare Tregëtare, në llogarinë bankare të Kontraktuesit me Nr. IBAN AL8120542146136096 CLPRCLALLR

**Neni 5**  
**DETYRIMET E KONTRAKTUESIT**

**Neni 5/1**  
**Gjatë ngritjes së kantjerit**

1. Të bëjë Akt dorzimin e sheshit të ndërtimit.
2. Të bëjë Raport për gjendjen faktike të sheshit, përputhjen e projektit me faktin dhe ndryshimet e nevojshme për realizimin e projektit.

**Neni 5/2**  
**Gjatë zhvillimit të punimeve**

1. Të bëjë kontrollin e materialeve që do të përdoren në kantier sipas kërkesave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.
2. Raport javor për ecurinë e zbatimit të punimeve në përputhje me grafikun e zhvillimit të punimeve.
3. Informacion për kontrollin e ushtruara në objekt.
4. Kontrolli i punimeve sipas KTZ dhe punimet e maskuara, me proces – verbalin përkatës.
5. Kontrollin e ditarit të objektit.
6. Të jetë i pranishëm çdo ditë në kantier për të ndjekur punimet.


**Neni 5/3**  
**Në përfundim të punimeve**

1. Konfirmon përfundimin e punimeve sipas kontratës së sipërmarrjes.
  2. Siguron nga sipërmarrësi deklaratën teknike.
  3. Harton relacionin përfundimtar për mbikëqyrjen e punimeve.
- Mbikëqyrësi i punimeve duhet të përgatisë dosjen për kolaudimin e punimeve jo më vonë se 10 ditë nga data e përfundimit të punimeve. Bashkëngjitur me relacionin përfundimtar të punimeve duhet të shoqërohet me këto dokumente:

- Projekti i plotë i zbatimit.
- Ndryshimet dhe shtesat në projekt.
- Preventivi i punimeve.
- Situacionet pjesore dhe përfundimtare të pranuar prej tij.
- Procesverbalet e punimeve të maskuara.

→ Për nënshtrësat.

→ Për rrjetin e infrastrukturës.







- Procesverbali i provave të sistemeve të infrastrukturës.
  - Pa ngarkesë.
  - Me ngarkesë.
- Çertifikatat e cilësisë së materialeve kryesore dhe produkteve të gatshme.
- Libreza e masave.
- Ditari i objektit.
- Deklarate teknike e sipërmarrësit.

**Neni 6**  
**PUNIMET NDËRPRITEN NË RAST SE:**

Autoriteti Kontraktor, Kontraktuesi ose Mbikëqyrësi i Punimeve bëjnë shkelje themelore të kontratës, ose Autoriteti Kontraktor ka arsye objektive. Atëherë Autoriteti Kontraktor bashkëpunon me Mbikëqyrësin dhe Kontraktuesin duke përpiluar procesverbalet e gjendjes së punimeve në çastin e ndërprerjes së punimeve shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e disponueshëm.

**Neni 7**

Mosmarveshjet midis palëve zgjidhen në rrugën e mirëkuptimit, në rast të kundërt zgjidhen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, në përputhje me Legjislacionin Shqipëtar.

Kontrata u hartua në 4 (kater) kopje nga të cilat 3 (tre) i merr Autoriteti Kontraktor dhe 1(një) Kontraktuesi.

**AUTORITETI KONTRAKTOR**

**BASHKIA MALIQ**

**Kryetari i Bashkisë**

**Z.Gëzim TOPÇIU**



**KONTRAKTUESI**

**“EDIFAT”**

**Përfaqësuar nga :**

**Z.Edmond Mecaj**